



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**FAKULTETI I INXHNIERISË MEKANIKE**  
 Rruga Agim Ramadani, Ndertesa e Fakulteteve Teknike, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
 Tel: +383 38 552 126 ext. 101 \* E-mail: [fim@uni-pr.edu](mailto:fim@uni-pr.edu) \* [www.fim.uni-pr.edu](http://www.fim.uni-pr.edu)

Nr. Prot.: 11  
 Datë: 06/01/2024

### RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	Departamenti i Komunikacionit / Komunikacion rrugor
Titulli i punimit	“PLANI I MOBILITETIT TË QËNDRUESHËM PËR ZONËN URBANE “MATI 1” NË PRISHTINË” <i>“Sustainable urban mobility plan for Mati 1 urban zone in Prishtine”</i>
Kandidati	Bsc. <b>Sadije Qenaj</b>
Mentori	Prof. ass.dr. Gëzim Hoxha
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 02.05.2024 Vendimi Nr.: 632/3-7

#### Konkluzion

Punimi i masterit me titull “Plani i Mobilitetit të qëndrueshëm për zonën urbane Mati 1 në Prishtinë”, i kandidates BSc. Sadije Qenaj, i përmbush parakushtet metodologjike, profesionale-shkencore dhe etike të një punimi të nivelit Master. Punimit i është bashkëngjitur edhe Deklarata e studentit për punë autentike.




Prandaj, në mbështetje të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe në mbështetje të Rregullores për studime Master, Komisioni për vlerësim, unanimisht dhe me kënaqësi i:

#### Propozon

Këshillin të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, të miratojë Raportin për vlerësimin e punimit për Master me titull “PLANI I MOBILITETIT TË QËNDRUESHËM PËR ZONËN URBANE “MATI 1” NË PRISHTINË”, i kandidatit BSc. Sadije Qenaj, dhe të bëjë procedimin e mëtejshëm, përkatësisht të formojë Komisionin për mbrojtje dhe të caktojë datën për mbrojtje publike të punimit.

Prishtinë: 06/01/2025

Komisioni:

1. Prof. ass. dr. Ramadan Duraku  - kryetar
2. Prof. ass. dr. Gëzim Hoxha  - mentor, anëtar
3. Prof. ass. dr. Arlinda Rrecaj  - anëtar

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.

## **PËRMBLEDHJA (ABSTRAKTI)**

Në kuadër hulumtimit të propozuar janë trajtuar problemet e lëvizshmërisë urbane në rrjetin e rrugëve të lagjes “Mati 1”, me theks të veçantë në rrugët: “Bahri Fazliu”, “Ali Aliu Kelmendi”, “Muharrem Fejza” dhe rrugët tjera lidhëse. Po ashtu është trajtuar imapkti i rrugës “A” në qëndrueshmërinë e lëvizshmërisë urbane në këtë zonë. Si zonë karakteristike me koeficient të lartë të përqendrimit të banimit dhe kërkesa të mëdha për lëvizje brenda zonës, kjo zonë urbane manifestohet me vështirësi të shumta në aspektin e përmbushjes së kërkesave të lëvizshmërisë urbane dhe probleme tjera që kanë impakt në cilësinë e jetës dhe sigurinë e përdoruesve të rrugës. Analiza e rrjetit rrugor në parimin gjithëpërfshirës të formave të ndryshme për lëvizje na ka mundësuar të kuptojmë më mirë dinamikën e lëvizjes në këtë zonë urbane dhe të planifikojmë implementimin e masave të cilat kanë përmirësuar parametrat cilësor të trafikut .

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të identifikohet dhe të propozohet një zgjidhje efektive për të përmirësuar lëvizshmërinë dhe për të ndërtuar një mjedis urban më të qëndrueshëm në lagjen "Mati 1". Në kuadër të projektit janë realizuar: mbledhja e të dhënave për gjendjen aktuale të trafikut dhe modelet e lëvizjeve të përditshme, identifikimi dhe vlerësimi i problemeve, kryerja e analizave të hollësishme për gjendjen ekzistuese të transportit, propozimi i masave konkrete për implementim dhe vlerësimi i ndikimit të zbatimit të masave të transportit të qëndrueshëm në cilësinë e trafikut dhe jetës urbane në përgjithësi. Rritja e kërkesës për lëvizje, urbanizimi i shpejtë dhe rritja e shkallës së motorizimit kanë krijuar sfida të shumta, duke përfshirë bllokimin e trafikut, ndotjen e mjedisit dhe impaktin në cilësinë e ulet të jetës urbane.

Nëpërmjet analizës së detajuar të nevojave dhe sfidave të komunitetit lokal, është synuar të zhvillohet një plan veprues që do të sjellë përmirësime në infrastrukturën dhe shërbimet e transportit, duke krijuar kushte më të mira për banorët dhe udhëtarët, duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik. Ky studim është fokusuar në analizën e ndikimit të faktorëve të ndryshëm, përfshirë rrjedhën e trafikut, mbipopullimin, kohën e udhëtimit, sigurinë rrugore, impaktin mjedisor dhe faktorët socio-ekonomikë në zhvillimin urban të lagjes "Mati 1".

Për të arritur këto objektiva, është miratuar një qasje gjithëpërfshirëse kërkimore, duke përfshirë rishikimin e literaturës, mbledhjen e të dhënave të trafikut dhe transportit nëpërmjet intervistave dhe anketimeve, përdorimin e numëruesve automatik të automjeteve, përdorimin e softuerit simulativ për testim dhe propozimin e masave konkrete për implementim. Prandaj, duke u bazuar në njohuritë

aktuale dhe praktikat më të mira në fushën e lëvizshmërisë urbane, ky studim ka synuar të paraqesë planin adekuat të masave për implementim dhe rekomandime të vlefshme për mobilitet të qëndrueshëm brenda zonës urbane "Mati1".